

VENDIM
Nr. 205, datë 4.3.2015

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT
“REHABILITIMI I STACIONIT TË POMPIMIT, TRUSH”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i projektit “Rehabilitimi i stacionit të pompimit, Trush”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të SHA Ujësllës Fshat, Shkodër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “arë”, me sipërfaqe të përgjithshme shpronësimi 41 636 (dyzet e një mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) m² dhe vlerë të përgjithshme shpronësimi 12 639 896 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 12 639 896 (dymbëdhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Ujësllës Kanalizimeve, zëri “Kosto lokale për rikonstruksionin e stacionit të Trushit”, me kod projekti M063465.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga SHA Ujësllës Fshat, Shkodër.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e listës që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënim “Konfirmuar ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të dorëzojnë dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë SHA Ujësllës Fshat, Shkodër.

8. SHA Ujësllës Fshat, Shkodër të kryejë likuidimin e pronarëve, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, në bashkëpunim me SHA Ujësllës Fshat, Shkodër, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të objektit në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga SH.A.Ujësllës Fshat, Shkodër dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë edhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të objektit në hartat kadastrale si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, SHA Ujësllës Fshat, Shkodër, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
SH. A. UJËSJELLËS FSHAT SHKODËR

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN NGA "REHABILITIMI I STACIONIT TE POMPIMIT TRUSH - SHKODER"

NR	Pronari			Zona Kad.	Nr. Pas.	Lloji pasuris e	Sip. Totale (m2)	Vlerësimet			Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri					Sip. Shpronësim (m2)	Cmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	
1	Bashkëpronarët "RROJI"			1648	103	arë	55970	17252	262	4520024	Konfirmuar ZVRPP
2	NAZIF	HALIT	PERVIZI	3205	1298/3	arë	2120	900	333	299700	Konfirmuar ZVRPP
3	HAJRULLAH		PELLUMBI	3205	1298/35	arë	2000	2000	333	666000	Konfirmuar ZVRPP
4	HAJRULLAH		PELLUMBI	3205	1298/36	arë	388	194	333	64602	Konfirmuar ZVRPP
5	FERID	SYLO	PELLUMBI	3205	1298/6	arë	3180	3180	333	1058940	Konfirmuar ZVRPP
6	XHEMAL	DAN	MUÇEJANI	3205	1298/7	arë	2120	1940	333	646020	Konfirmuar ZVRPP
7	MUSA	OSMAN	MUÇEJANI	3205	1298/37	arë	2000	1864	333	620712	Konfirmuar ZVRPP
8	MUSA	OSMAN	MUÇEJANI	3205	1298/38	arë	976	821	333	273393	Konfirmuar ZVRPP
9	HYSNI	OSMAN	MUÇEJANI	3205	1298/10	arë	3000	3000	333	999000	Konfirmuar ZVRPP
10	ZENEL	BRAHIM	MUÇEJANI	3205	1298/9	arë	2000	2000	333	666000	Konfirmuar ZVRPP
11	HAMDI	OSMAN	MUÇEJANI	3205	1298/11	arë	2500	2008	333	668664	Konfirmuar ZVRPP
12	ENVER	KASEM	BUSHATI	3205	1298/12	arë	3710	2783	333	926739	Konfirmuar ZVRPP
13	ENVER	TEOFIK	VERRI	3205	1298/39	arë	3600	2365	333	787545	Konfirmuar ZVRPP
14	DYLAVER	TEOFIK	VERRI	3205	1298/41	arë	4000	1329	333	442557	Konfirmuar ZVRPP
	SHUMA							41636		12639896	